

FJALA E DEPUTETIT XHELAL MZIU

E ENJTE 20 TETOR 2022

E nderuar zonja Kryetare e Kuvendit,

Të nderuar kolegë,

Të dashur qytetarë,

Sot jemi për të diskutuar në lidhje me OSHEE-në, me “sukseset e jashtëzakonshme” që ka pasur kjo qeveri dhe, në fakt, sa herë ndodh ndonjë fenomen ndërkombëtar ose ndonjë tërmet, apo ndonjë luftë diku larg apo ndonjë pandemi, që nuk ka asnjë lloj lidhjeje, televizionet mbushen me propagandë, se është lufta, është pandemia, është tërmeti dhe, mbi këtë bazë, fillon pastaj edhe pjesa e abuzimit apo e uljes së pagave, apo e rritjes së çmimeve, që konvertohet në një standard shumë më keq sesa më parë.

Mjafton të shohësh vetëm borxhin publik të OSHEE-së, që, në raport me vitin 2021, në tetëmujorin e parë është rritur dhe është plot 687 milionë euro.

Çudia ndodh që qytetarët e thjeshtë janë më korrektë, paguajnë më mirë, edhe pse 56% e këtij borxhi është ulur në raport me vitin 2021, pra borxhi i familjarëve. E kundërta ndodh me borxhin publik, sepse jo vetëm që nuk është ulur, por është rritur në një masë që varion nga 5% deri në 15% sipas jobuxhetorëve apo enteve të tjera shtetërore. Dhe, në fakt, borxhlinjtë më të këqij të tyre janë ujësjellësit, të cilët janë kthyer në gangrenë për buxhetin e shtetit apo OSHEE-në, aq më tepër kur ndodhi edhe liberalizimi i energjisë elektrike.

Janë plot 200 milionë euro borxhet që kanë ndërmarrjet e ujësjellësve ndaj OSHEE-së. Jam i sigurt se kjo rritje deri në mbylljen e vitit do të rritet shumë herë më tepër.

Në fakt, kjo situatë e përkeqësuar ka një aktor. Është qeverisja që i bëhet OSHEE-së, e cila, në fakt, po shkon drejt 1 miliard eurove të marra borxh për të përmirësuar parametrat. Mbaj mend se vitin e kaluar pretendonim që nga 21% të shkonim në 16% të humbjeve të energjisë elektrike dhe, në fakt, në terma realë, humbjet e energjisë elektrike janë në shifrat 33% deri në 34%, pavarësisht këtij borxhi të jashtëzakonshëm. Kjo vjen edhe për shkak të ping-pongut që luhet ndërmjet OSHEE-së dhe OST-së, KESH-it apo të tjera instrumenteve që përdorin në shitblerje, ku njëra del me humbje dhe tjetra me fitim, apo edhe në veprimet e ndryshme që bëhen në blerjen e energjisë, që blihet shtrenjtë dhe shitet lirë, e cila e ka kthyer tejet kaotike energjinë elektrike.

Ama, nuk është vetëm aq. Po të shohësh, situata me energjinë elektrike është akoma më keq edhe për shkak të patronazhistëve. Është i vetmi institucion i cili e ka rritur në mënyrë drastike numrin e rrogëtarëve, pavarësisht se sot kudo që të shkosh elektrikistët mungojnë, dhe fondi i pagave është trefishuar krahasuar me vitet e mëparshme.

Dëgjova ministren që kujtoi vitet 2005-2007, kur kërciste gjeneratori. Është e vërtetë, madje në çdo rrugicë dëgjohej zhurma. Po të shkoje në Rrugën e Durrësit, dëgjoje të paktën nja 500 zhurma sipas fuqisë së gjeneratorit.

E, në fakt, nga viti 2008 e në vazhdim nuk pati gjeneratorë, por në tre-katër vjetët e fundit ka filluar zhurma e gjeneratorit gjë, që, në fakt, është skandaloze.

Pavarësisht se u prodhua për shkak të hidrocentraleve private një numër i konsiderueshëm dhe që e tejkaloi në këtë gjashtëmujor të parë atë që ishte shtetërore, prapë ne e vuajmë. Tjetra, nuk besoj se Skavica është zgjidhje. Zgjidhja është energjia alternative. Mbahet monopol nga qeveria.

Nuk jepet leje për hidrocentralet që janë, nuk jepet leje as për energjinë e erës dhe të diellit. Më e keqja është se trumbetohet Skavica, ndërkohë që ministrja sapo tha që do të prodhojmë 350 megavatë në Vlorë. Atëherë, meqenëse do ta prodhojmë këtë energji, pse të bëhet Skavica? E nëse është kaq e nevojshme për t'u prodhuar energjia, pse të prodhohet në Skavicë? Të mbarojmë me Vjosën për të cilën ishin të gatshme edhe projektet dhe pastaj të vazhdojmë me pjesën e Skavicës.

Ky është standardi i shpërndarjes së energjisë elektrike në Dibër. Ky është standardi që kemi sot kudo që të shkosh. Jemi në vitin 2022 dhe nuk ka asnjë të krahasuar me trendin e zhvillimit të infrastrukturës dhe të furnizimit me energji elektrike gjatë viteve 2008-2013. Faleminderit!